

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje F.V Chillera”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)** 39715200-9 (Paisje për ngrohje); 42510000-4 (Njësi shkëmbim nxehtësie dhe makineri për hollimin e ajrit ose gazeve të tjera); 44621220-7 (Kaldaja me ngrohje qëndrore);

**VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 12,491,394** (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e një e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e e kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Kriteret e mesiperme janë vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “**Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.***

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë b) vlerën e përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.2.3.** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

**2.2.4** Vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenin 39, pika 8 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Bashkia Tiranë nëpërmjet “Ujësjelles Kanalizime Tiranë” sha ka si objektiv kryesor garantimin e shërbimeve jetike të furnizimit me ujë në territorin e Bashkisë Tiranë ku dhe një nga prioritetet bazë është mbledhja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është për të siguruar Autoritetin Kontraktor që për dhënien e kontratës të kontraktohen operatorë ekonomik të cilët nuk kanë detyrime të pashlyera për furnizimit me ujë sipas objektin ku ushtrojnë aktivitetin, në Bashkinë e Tiranës. Vendsoja e këtij kriteri siguron institucionin e Bashkisë Tiranë edhe në rast detyrimesh të pashlyera, operatorët ekonomik kanë periudhën e nevojshme kohore për të shlyer këto detyrime përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Vendosja e këtij kriteri është propocion me objektin e kontratës, për sa kohë është detyrim i cdo shoqërie shlyerja e detyrimeve të shërbimeve të furnizimit me ujë në territorin ku ushtron aktivitetin, konkretisht Bashkia Tiranë.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së pajisjeve (jo më pak se pesë vite), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, zëvendësimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike.

**Afati i shërbimit për riparimin e tij: Nga dita e njoftimit operatori ekonomik duhet të kreyj riparimin për një afat maksimal deri në 10 (dhjetë) ditë pune.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40 pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kjo deklaratë është kërkuar me qëllim që të garantohet trajtimi i garancisë, për të siguruar që koha e përgjigjes do të jetë minimale.

Servisi i pajisjeve brenda garancisë garanton menaxhimin dhe trajtimin e shpejtë të paisjeve në rast nevojë riparimesh fizike si edhe cilësinë e ndërhyrjes së mundshme në pajisje. Koha e riparimeve fizike është shumë e rëndësishme për rikthimin e paisjeve në punë dhe vazhdimin e procesit të punes.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të gjitha shpenzimet për materiale perfshire dhe transportin e tyre si dhe vënien në funksion F.V Chillera.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që vërtetojnë dhe zotërojnë kapacitetin për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Në këtë rast, për shkak të rëndësisë së objektit të prokurimit, deklarimi me shkrim nga OE për realizimin e të gjitha specifikimeve teknike dhe shërbimit objekt prokurimi shërben si angazhim paraprak që garanton seriozitetin e ofertës dhe përgatitjen për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në DST.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pjesët e këmbimit janë të reja, dhe janë konform standardeve të BE-së .

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që vërtetojnë dhe zotërojnë kapacitetin për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Në këtë rast, për shkak të rëndësisë së objektit të prokurimit, deklarimi me shkrim nga OE për realizimin e të gjitha specifikimeve teknike dhe shërbimit objekt prokurimi shërben si angazhim paraprak që garanton seriozitetin e ofertës dhe përgatitjen për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në DST.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skede teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, për mallrat që oferton duke shënuar/markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun/skedën teknike të pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Kataloget duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike të lëshuar/publikuar nga

prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK- Bashkia Tiranë verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si me poshte.

**\*ISO 9001:2015 (ose e përditësuar)** në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;

**\*ISO 45001:2018 (ose e përditësuar)** për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;

**\*ISO 140001:2015 (ose e përditësuar)** për sistemin e menaxhimit të mjedisit;

**\*ISO 50001:2018 (ose e përditësuar)** për sistemin e menaxhimit të energjisë;

**Argumentimi:** Kriteret për paraqitjen e ISO-ve sa më sipërcituar u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit.

**ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot

si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Kërkesa për ISO 45001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

**ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”** specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimin të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

**ISO 50001:2018 (ose e përditësuar) “Sistemi i menaxhimit të energjisë”**, është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për të gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë, duke konsideruar përfshirjen e stafit në këtë proces

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës sipas kushteve dhe brenda afatit. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 8 (tetë) punonjës të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier elektrik-drejtues teknik në licencën e shoqërisë;
- 1 (një) inxhinier mekanik, si staf mbështetës;
- 2 (dy) punonjës të specializuar me certifikata profesionale sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:
  - a) 1 (një) teknik kondicioner
  - b) 1 (një) punonjës hidraulik, të jetë i pajisur edhe me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë trajnimi ”Pergjegjes per Sigurine dhe Mbrojtjen e Shendetit ne Pune.

*Në lidhje me stafin e kërkuar si më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:*

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
  - CV
  - Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/privatë të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;
  - Listëpagesat sipas formularit eSig25 për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.
- 1 (një) vlerësues për Ndikimin në Mjedis dhe auditimin mjedisor i certifikuar për Ndikimin në Mjedis dhe Auditimin Mjedisor si dhe të jete në listepagese.

- 1 (nje) vleresues per 'Vleresimin e linjave Teknologjike ,makinerive dhe Pajisjeve i certifikuar për "Vlersimin e linjave teknologjike,makinerive dhe pajisjeve".
- 1 (nje) punonjes te pajisur me certifikate Audtimi Energjie ne profilin Auditim energjitik ne Ndertesa.

*Në lidhje me stafin vleresues dhe auditues, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:*

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
- CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licënuara sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar;

**Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime sipas kërkesave më sipër.**

*Shënim: Kriteri Nr.2.3.7 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit*

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

*Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve te instalimit (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapacitetit teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.*

*AK argumenton se kërkesa për stafin teknik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".*

*Kërkesa specifike për punonjesit e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve te instalimit (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas kapacitetit teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Preventivin rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.*

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:Në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier".*

*"Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve" mbështetet në ligjin e ri Nr. 80, datë 22. 07. 2015 "*

*Specialisti per -Vlerësimin i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve eshte i nevojshem për t'ju përgjigjur jo vetem teknologjive bashkëkohore, por edhe atyre për mbrojtjen e mjedisit. Specialisti eshte koherent me standartet*

dhe direktivat europiane te makinerive dhe paisjeve per te siguruar nje nivel te larte te të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë së njerëzve.

Vleresuesi I ndikimit ne mjedis ka per qellim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis

Specialisti per auditim energjie eshte i nevojshem per te gjetur mënyra në identifikimin e mundësive për të reduktuar konsumin e energjisë.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR), në pajtim me Ligjin nr 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në Punë”, i ndryshuar, sipas fushes së objektit te veprimtarisë, të lëshuar nga institucione kombëtare/ndërkombëtare të licënuara nga Republika e Shqipërisë/Ministria e financave. (Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1 (një) certifikate nga njëri prej operatorëve të bashkuar).

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36 dhe 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nën të 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri, autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim për të provuar kapacitetet teknike të OE të cilët do të angazhohen në plotësimin e kushteve të kontratës sipas preventivit dhe specifikimeve teknike, ku operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatë “Për formim dhe trajnim të punëtoreve në pajtim me Ligjin nr.10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në Punë” i ndryshuar, sipas fushës së objektit të veprimtarisë, të lëshuar nga institucione kombëtare/ndërkombëtare të licënuara nga Republika e Shqipërisë/Ministria e financave. (Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1 (një) DVR për të gjithë BOE).

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë 1(një) automjet per transportin e mallrave, të cilat duhet t'i ketë në pronësi/me qira nga një operator ekonomik;

Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin që vërteton pronësinë ose qiramarrjen.

**Shënim:** Kriteri Nr.2.3.9 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.10** Operatorët ekonomik ofertues duhet të ketë dhe paraqesë **Licenca profesionale** për aktivitetin qe ushtron si më poshtë:

- Për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur me licence profesionale, (Referuar VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, sipas kategorive të mëposhtme:

- **NS-12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit);**
- **NS-14/A (Impiante të brendshme elektrike, etj);**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet:

*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”* Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë propocionale me objektin e kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike :**

*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.Specifikimet teknike të pajisjes që është objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;*

### **Specifikimet teknike:**

- Heqja e paisjeve të vjetra: Demontim i paisjeve ekzistuese termike/ ftohëse sipas standarteve të sigurisë industriale.
- Pastrimi i materialeve të panevojshme brenda ambjentit teknik: Spastrimi i materialeve të panevojshme ndertimore/instaluese për të siguruar akses dhe pastërti funksionale për montimin e sistemeve të tjera .
- Reabilitimi i tubacioneve ekzistuese për përshtatje me sistemin e ri: Rilidhja ose zëvendësimi i segmenteve të linjave hidraulike /ajrore ekzistuese për përputhshmëri me paisjet e reja, duke respektuar normat ISO.
- Furnizim dhe vendosje e Chillera 30 KW: Paisje të tipit Chiller me kapacitet termik 30 kw secili, me efikasitet energjetik EER  $\geq 3.0$  gaz frigoriferik R 32 A/ R32 / R 410.
- Furnizim dhe vendosja e 3 akumulatorëve nga 300 litra: Rezervuare uji të presionit për ruajtjen e energjisë termike kapacitet 300 litra, me izolim termik  $\geq 50$  mm poliuretani dhe sonda temperature.

- Sistemi i furnizimit me eneregji elektrike për chillerat: Instalimi i paneleve elektrike, kabllave trefazor, mbrojtje termike dhe automatizim për secilin njësi chiller, sipas rregulloreve të tensionit të mesëm 400 v/50 hz.
- Lidhja e Sistemit Modulare të gjithave për punimin e tyre më efçente: Konfigurimi hidraulik dhe elektronik i paisjeve në mënyrë paralele ose kaskadë për funksionim të optimizuar.
- Largimi i paisjeve të vjetra me mjete: Transport i sigurt dhe depozitimi i paisjeve të demantuara në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve teknike.
- Aksesorë dhe material çeliku për realizimin me impiantin ekzistues: Struktura mbajtëse, nyje lidhëse, suportë për tuba, flange inox dhe element bashkues për integrim të impiantit të ri me sistemin ekzistues.
- Ventilator katrore për rritjen e sasisë së ajrit në dhomën teknike: Ventilatorë centrifugale ose axial me kornizë metalike, me kapacitet qarkullimi  $\geq 5000$  m<sup>3</sup>/h, tension 400 V.
- Materiale llamarine për largimin e ajrit mbas procesit të shkëmbimit ajër /ujë: Kanale llamarine galvanizuar ose inox, të izoluar, për nxjerrjen e ajrit të nxehtë të përdorur nga chillerat.
- Furnizim dhe vendosja e pompave të reja objektin DN65: Pompa centrifugale me hyrje /dalja DN65 trup gize ose bronzi, kapacitet pompuese 10- 150 m<sup>3</sup>/h, presion maksimal  $\geq 6$  bar.

**Garanci:** periudhën e garancisë së pajisjeve (jo më pak se pesë vite),

**Shënim:** Operatori ekonomik fitues duhet të marrë përsipër furnizimin/vendosjen e chillerave. Gjatë perjudhes së garancise ofertuesi do të sigurojë riparimin, zëvendësimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike.

**Shënim:** Afati i shërbimit për riparimin e tij: Nga dita e njoftimit operatori ekonomik duhet te kreyj riparimin për një afat maksimal deri në 10 (dhjetë) ditë pune.

**Shënim:** Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, originë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Sa më sipër, kërkesat për kualifikim, janë hartuar nga njësia e prokurimit konform kriterëve dhe specifikimeve teknike hartuar nga specialist I fushës. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personat përgjegjës për prokurim.

#### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- Dokumentat e tenderit
- Specifikimet teknike

#### **Njesia e prokurimit**